

# community

The New Apostolic Church around the world

01/2019/AI

Motivi për vitin 2019:

## Të pasur në Krishtin

Editoriali: Apostuli  
kryesor rreth Vitit të Ri

Shërbesa fetare:  
Në rrugën drejt lirisë

Mësimet e Kishës:  
Përgjithësia e Kishës

New Apostolic Church  
International



# Të pasur në Krisht

Të dashur motra e vëllezër,

mirë se erdhët në Vitin e Ri. Dëshira ime është: Le ta fillojmë me bindjen në besim, e cila tek Psalmi 23 shprehet kështu: „Zoti është bariu im, mua nuk do të më mungojë asgjë!“

Pavarësisht shqetësimeve, përpjekjeve dhe frikës, ne mund të themi me bindje: Perëndia është pafundësisht i pasur – i pasur në mirësi, i pasur në durim, i pasur edhe në mëshirë.

Dhe ai dëshëron ta ndajë me ne pasurinë e tij. Ne mund të kemi pjesë në këtë pasuri – e pikërisht në Jezu Krishtin.

Dhe ai dëshëron ta ndajë me ne pasurinë e tij. Ne mund të kemi pjesë në këtë pasuri – e pikërisht në Jezu Krishtin.

Të dashur motra e vëllezër, për vitin 2019 ju rekomandoj, që të përqendrohemi tek ky qëllim: Ne duam të pasurohemi në Krishtin! Prandaj le të qëndrojmë nën këtë motiv: *Të pasur në Krishtin!*

Nga se përbëhet kjo pasuri? Si mund ta arrijmë atë? Me këto pyetje duam të merremi ne në javët dhe muajt e ardhshëm. Unë jam shumë kureshtar të di, se çfarë idesh do të shpalosë Shpirti i Shenjtë tek secili prej jush dhe në bashkësi.

Përveç kësaj më vjen ndër mend edhe një mendim tjetër, i cili është shumë i rëndësishëm për ne: Pasurinë në Krisht



Foto: NAC International

ne mund ta ndajmë – ta ndajmë pa u varfëruar vetë. Le ta ndajmë pasurinë në Krisht me njerëzit e tjerë.

Kjo nuk është vetëm një mundësi apo një nevojë, kjo është edhe vendosmëria jonë.

Ju uroj një Vit të Ri 2019 të mbushur plot me bekime!

Juaji Jean-Luc Schneider

# | Në rrugën drejt lirisë



Shërbesë fetare më 15 Prill 2018 në Toronto (Kanada)

Photos: NAC Canada



Gjoni 8,36:

*„Nëse Biri do t’ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë.“*

Të dashur motra e vëllezër, dua të ndaj në fillim me ju një gëzim personal. Si apostul kryesor unë nuk kam “Mendimet Udhëzuese për shërbesën fetare”. Unë duhet të kërkoj vetë një fjalë në Bibël dhe kjo lidhet shpesh me shqetësimin: A është mirë kjo? A është kjo fjala e kërkuar? ... U bëra i vetëdijshëm për këtë fjalë dje dhe sot, kur pashë këngën e hyrjes, të fillimit, të cilën e kish zgjedhur apostuli juaj i distriktit. Teksti i sotëm i marrë nga bibla citohet edhe tek strofa e parë e këngës. Kjo që një shenjë për mua: „Oh, këtë e ka zgjedhur vetë Zoti,“ dhe kjo më bëri të lumtur.

Jam i vetëdijshëm që këtu sot nuk mundën të vijnë të gjithë ata, të cilët janë ftuar për këtë shërbesë fetare për shkak të motit të keq [shenim i redaksionit: një stuhi akulli]. Doja të thoja diçka këtu. Ndoshta tashmë pyesin disa: „Përse nuk

na u dha ne mundësia për të përjetuar këtë shërbesë?“ Ne nuk duhet të bëjmë fajtor djallin, pasi ai nuk është fajtor për motin. Mbi motin vendos Perëndia dhe na e bën më të vështirë përgjigjen, pasi me siguri jemi lutur të gjithë për këtë shërbesë fetare. Ne jemi përgatitur, provat e korrit janë bërë dhe tani e shohim që Zoti ka vendosur të sjellë kushte të veçanta moti, të cilat penguan shumë për të ardhë. Pra, çfarë po ndodh kështu? Ndoshta dikush mendon tani se nuk është lutur mjaftueshëm apo ndoshta ka bërë diçka jo në rregull. Motra e vëllezër, definitivisht që nuk është kështu. Për ta sqaruar: Qe vullneti i Perëndisë. Nuk qe faji juaj. Askush nuk ka faj për këtë.

Kujtoni Apostul Palin. Ai ishte bërë gati disa herë të vizitonte bashkësinë e Romës, por ai ishte penguar gjithmonë (Rom 1,13). Pali qe një njeri i madh i Perëndisë: Ai lutej fort, por megjithatë nuk mund të bënte gjithnjë, atë që me të vërtetë donte. Sigurisht që kishte menduar se: Eshtë me të vërtetë mirë për bashkësinë e Romës por edhe për mua nëse i vizitoj një herë, por ai ishte penguar. Perëndia e pa atë ndryshe. Përse, nuk e dinte Pali. Ne duhet ta pranojmë, se nuk jemi në gjendje të kuptojmë Zotin. Profet Isaia thoshte: „Sepse mendimet e mija nuk janë mendimet tuaja, dhe rrugët tuaja nuk janë rrugët e mija, thotë Zoti, përkundrazi aq sa larg është qielli nga toka, kaq larg janë rrugët e mija nga rrugët tuaja dhe mendimet e mia nga mendimet tuaja“ (Isaia 1,8-9). Ne nuk mund ta perceptojmë zotin me mendjen tonë, e aq më tepër nuk mund t'i kuptojmë bëmat e tija.

Ndonjëherë i përgjigjet lutjeve tona, ndonjëherë jo. Mund të thonim: „Jezusi na ka premtuar: „Dhe çfarëdo të kërkonin në emrin tim, do ta bëj“ (Gjoni 14,13). Por pikërisht kjo është çështja: Të lutesh në emër të tij. E për çfarë lutej Jezusi vallë? Ai i thoshte Atit të tij: „Unë nuk kërkoj që ti t'i heqësh nga bota, por që ti t'i mbrosh nga i ligu“ (Gjoni 17,15). Kështu është lutur Jezusi. Ne nuk mund ta detyrojmë Perëndinë të bëjë asgjë, edhe kur kemi bërë gjithshka në rregull dhe kur mendojmë se, pikërisht tani duhet të vepronte Perëndia e të bënte siç duam ne. Ai bën çfarë do vetë. E vetmja gjë për të cilën duhet të jemi të sigurt është: Perëndia do ta plotësojë premtimin e bërë. Ai ka premtuar: „Unë të dua dhe dëshiroj që edhe ti të jesh në përjetësi pranë meje dhe të jemi të bashkuar përjetësisht.“

Jezusi vdiq për mëkatet tona, me qëllim që ne të hyjmë në mbretërinë e tij. Ai ka thënë: „Nëse ti pranon fjalën time, nëse pranon apostujt, të cilët u dërguan për të përgatitur ty si pjesë e bashkësisë nuse, ti do të hysh në mbretërinë time.

Unë do të vij përsëri për të të marrë ty atje ku jam unë.“ Ky është premtimi hyjnor, themeli i besimit tonë. Ne nuk besojmë se Zoti do të na jape gjithçka, që ne i kërkojmë atij. Ne nuk besojmë gjithashtu se mund ta detyrojmë Perëndinë për diçka. Ne i lutemi atij – dhe ndonjëherë ai na përgjigjet, por ndonjëherë jo. Ne kemi besim tek dashuria e tij. Për një gjë duhet të jemi krejtësisht të bindur: Ai do ta plotësojë premtimin e tij dhe do të dërgojë Birin e tij të dashur dhe të gjithë ata, që i kanë qëndruar besnikë Jezu Krishtit, ata që janë përgatitur nëpërmjet apostujve për rikthimin e tij, do të bashkohen përjetësisht me të. Të dashur motra e vëllezër, ne duhet ta drejtojmë vështrimin tonë drejt këtij premtimi. Këtë premtim ai do ta përmbushë. Dhe për gjithçka tjetër e dimë, që nuk mund ta kuptojmë atë, por vetëm i besojmë atij. Ai do të kujdeset për të na dhënë gjithshka që na nevojitet për rikthimin e Jezusit.

Le të kthehemi tani tek fjala e marrë nga Bibla. Këtu Jezusi u drejtohet judëve, të cilët besonin tek ai. Ai u thotë atyre, se mund t'i çlironte ata. „Liri“ do të thotë për ne sot në rradhë të parë: Të mos jesh i burgosur. Liri do të thotë gjithashtu: Të kesh të drejtën për të lëvizur apo për t'u shprehur, pa pasë frikë se dikush mund të të ndalonte. Kështu e kuptojmë ne termin „liri“ sot.

## „E Vërteta do t'ju çlirojë“

Megjithatë, në kohën e Jezusit, kjo ka qenë pak më ndryshe. Jezusi e ka shpjeguar se çfarë kupton ai me fjalën liri. Ai e krahason gjendjen e një shërbëtori me atë të një fëmije. Një shërbëtor apo një skllav nuk është i lirë, pasi ai jeton nën sundimin e zotit të tij dhe duhet të përmbushë vullnetin e tij. Ai duhet të punojë për zotin e tij dhe nuk paguhet për punën që bën. Kjo është gjendja e një shërbëtori. Në të kundërt një fëmije i duhet me të vërtetë t'i bindet prindërve tij, por më në fund ai trashëgon gjithshka të tyre. Këtë ndryshim bën edhe Jezusi. Kështu e shpjegon ai lirinë.

Jezusi u tha atyre: „E vërteta do t'ju bëjë të lirë“ – çfarë i mërzi të judenjtë. Ata iu përgjigjën atij: „Ne jemi pasardhësit e Abrahamit dhe nuk kemi qenë kurrë shërbëtorë të dikujt.“ Ata ishin të zemëruar: „Si mund të na thuash, se ti do të na çlirosh. Ne jemi të lirë.“ Neve na duket si çudi, pasi e dimë se ata ishin nën sundimin e Romakëve. Ishte koha e pushtimit romak. Ata vuanin nën këtë pushtim, e megjithatë imagjinonin se ishin të lirë dhe se kishin të drejta. Sepse, edhe pse vendi i tyre ishte i pushtuar nën sundimin romak, ata mbetën judë. Romakët nuk arritën kurrë t'i detyronin të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Ata mbareshin fort pas besimit të tyre, pas ligjeve dhe traditës së tyre. Ata nuk u bënë kurrë romakë dhe kjo është ajo çfarë



nënkuptohet këtu me: „Ne jemi të lirë. Edhe pse armiku, ushtria romake është këtu, ne jemi të lirë. Ne ruajmë fort besimin tonë, ligjet dhe traditën tonë.“ Ne shpesh kemi një mendim negativ për judët e asaj kohe, por më duhet të them, se ata janë për t'u admiruar. Nuk janë të shumtë popujt, të cilët pavarësisht se çfarë kanë përjetuar, të jenë kaq të suksesshëm dhe të ruajnë besimin, ligjet dhe traditën e tyre. Ata ishin të ndërgjegjshëm: Ky është identiteti ynë, këta jemi ne. Ne duhet të mbahemi fort pas tyre, sido që të ndodhë. Për këtë gjë i admiroj.

Ne duhet të mësojmë nga kjo. A jemi ne si të krishterë po kaq të fortë? A mund të themi ne, se çfarëdo që të na ndodhë – edhe nëse jemi nën robërinë apo pushtimin e shpirtrave të huaj – ne jemi dhe do të mbesim të krishterë. Edhe pse kjo botë sundohet nga leku, nga paraja, edhe pse ka shumë lloj mendimesh e pikëpamjesh, ne do të mbesim të krishterë. Në identitetin tonë bën pjesë, që të shkojmë të dielave në kishë, në shërbesë fetare për të adhuruar Perëndinë. Ne kemi nevojë për atë lutje të përbashkët. Ky është besimi ynë, ligji ynë. Në jemi të krishterë dhe japim sakrificën tonë dhe askush nuk mund të na detyrojë të heqim dorë nga kjo gjë. Ky është identiteti ynë. Ne, si të krishterë, duam të jemi të lirë: Ne jemi të krishterë dhe do të mbetemi të tillë. Edhe nëse bota do të sundohet nga frymëra dhe influence të tjera, ne do të tregojmë dhe dëshmojmë, se jemi të krishterë dhe do të mbetemi të tillë. Ky është aspekti i parë i të qenurit i lirë.

*„ Çfarëdo që të ndodhë, ne jemi dhe do mbetemi të krishterë”*

Sigurisht që Jezusi ka pasë diçka tjetër parasysh dhe iu desh t'ua sqaronte këtë: „Ok, por ju jeni akoma robër të mëkatit.“ Kjo qe shumë e vështirë për ta kuptuar judët. Adami dhe Eva dëgjuan gjarprin, i cili u premtoi atyre shumë gjëra. Ata e dëgjuan atë, por së fundi u zhgënjyen, u tradhëtuan. Për shkak të vendimit të gabuar u bënë shërbëtorë të së keqes, të së ligut. Për shkak të këtij mëkati të parë, të gjithë njerëzit janë robër të së keqes, të së ligut.

Ndërmjet Perëndisë dhe njeriut është krijuar një hendek, i cili e bënte të pamundur bashkimin e njeriut me Perëndinë.

Tek Ungjilli sipas Lukës Jezusi thotë, se u dërgua për t'u shpallur lirinë të burgosurve, robërve. Ai thoshte: „Unë mund t'u shpëtoj,

t'ju çliroj, që të mos jini më robër të së keqes, të së ligut. Ata, të cilët për arsye të sakrificës sime deri në vdekje, besojnë tek unë, do të kenë mundësinë të shkojnë tek ai dhe të bashkohen përsëri me Perëndinë. Ata nuk janë më robër.“ Këtë ka pasë parasysh kur ka thënë: „Kur Biri t'ju çlirojë, atëhere do të jeni me të vërtetë të lirë“ (Gjoni 8,36). Ata nuk do të jenë më të lidhur prej mëkatit. „Kush beson në të, atij do t'i jap forcën dhe ndihmën që i duhet për të kundërshtuar, për t'i thënë jo së keqes dhe mëkatit. Ne nuk na detyron kush të bëjmë të këqija. Ne mund të bëjmë të mira. Është vendimi ynë, dhe kur marrim vendim për të bërë të mira, unë do t'ju ndihmoj për këtë vendim.“ Ky është një aspekt tjetër i lirisë. Ata, të cilët besojnë në Jezus, që janë pagëzuar në emër të tij, janë të çliruar nga ky sundim. Ata nuk janë më robër të së keqes, porse mund të



shkojnë drejt Zotit. Kjo është liria e vërtetë, të cilën Jezusi mund t'u japë njerëzve.

Kjo liri është gjithashtu një proces i vazhdueshëm. Pagëzimi është vetëm fillimi i tij. Tek 2. Korint 3,17 shkruhet: „Zoti është Fryma; dhe aty ku kjo Frymë sundon, atje është liria.“ Fryma e Zotit na ndihmon për të fituar lirinë në Krishtin. Dhe këtë proces duam ta ndjekim. Ne duam të jemi po aq të lirë, sa qe edhe Jezusi. Ne duam të jemi të lirë në Jezu Krishtin. Dhe ne mund të jemi po aq të lirë sa Jezu Krishti, nëpërmjet veprimit të Frymës së Shenjtë, nëpërmjet predikimit të Ungjillit, nëpërmjet Darkës së Shenjtë dhe me ato dhunti të Shpirtit të Shenjtë, të cilat ne i kemi marrë tashmë. Si tregohet kjo liri atëhere?

Pali u shkroi Romakëve: „Sepse ligji i Frymës i jetës në Jezu Krishtin më çliroi nga ligji i mëkatit dhe i vdekjes“ (Rom 8,2). Ligji parashikon disa gjëra. Po kështu edhe ligji jud: Duhej të përmbusheshin shumë rregulla, t'i zbatoje ato dhe nëse jo, atëhere ndëshkoheshe. Ky qe edhe ligji i Moisiut. Jezusi thoshte: „Nëse keni shpirtin e Perëndisë, nëse keni shpirtin tim dhe nëse ndiqni fjalën time, jeni të çliruar nga ky ligj“. Si është e mundur kjo? Është krejtësisht e thjeshtë, pasi me marrjen e Vulës së Shenjtë u derdh në zemrat tona dashuria e Perëndisë. Ne nuk e dëgjojmë më Zotin me detyrim.

Tani është krejtësisht ndryshe. Ne e duam Zotin dhe mezi presim të bashkohemi me të. Ne e kemi kuptuar se rruga për t'u bashkuar me Perëndinë është t'i bindesh atij. Dhe kështu ne kemi vendosur me vullnetin tonë të lirë, që t'i zbatojmë rregullat, pasi duam të jemi të bashkuar përjetësisht me të. Sepse e duam Perëndinë dhe duam të jemi të bashkuar përjetësisht me të, ne e ndjekim pas Jezu Krishtin në atë rrugë që ai vetë e ka shtruar. Dhe papritmas është vendimi ynë. Ne jemi të çliruar nga ligji, Nuk ka më shtrëngim. Ne e zgjodhëm këtë rrugë me vullnetin tonë të lirë. Ne duam të jemi me Perëndinë, dhe kjo është rruga, që të çon drejt tij. Dhe këtë rrugë duam të ndjekim. Ne kemi përjetuar që, kur i zbatojmë rregullat, ligjet, Perëndia jeton brenda nesh. Dhe kjo është një ndjesi e mrekullueshme. Ne dëshirojmë të kemi lirinë në Krishtin. Ne kemi vendosur për këtë rrugë.



Nuk na detyron askush që të ecim në këtë rrugë, ne kemi vendosur me vullnetin tonë të lirë për të.

Ka edhe një aspekt tjetër. Kjo liri, e cila vjen prej Jezu Krishtit, na dhurohet. Ai na e jep këtë liri, pa pritur „asgjë“ prej nesh. Kjo është një cilësi e Perëndisë, i cili na jep falas gjithçka, që na nevojitet për shpëtim, për çlirim. Nëse jemi të vetëdijshëm që e marrim falas shpëtimin, çlirimin nëpërmjet Jezu Krishtit, atëhere dëshirojmë edhe ne t'i japim me vullnetin tonë të lirë diçka Perëndisë: besimin që kemi tek ai, bindjen tonë e kështu me rradhë. Dhe këtë nuk e bëjmë nga ana jonë për të na e shpërblyer Zoti apo për të kërkuar diçka prej tij, porse pasi jemi në gjendje të punojmë nga ajo liri, nga ai çlirim që kemi marrë prej Jezu Krishtit. Ne i shërbejmë atij, pa pritur prej tij shpërblim. Tek letra drejtuar Efesianëve thuhet, se ne jemi skllavër të Krishtit (Efes 6,6). Një skllav bën atë që i thotë zotnia e tij. Ai bën punën e nuk merr asgjë për këtë mund të tij. Jezu Krishti ka bërë me të vërtetë shumë për të tjerët dhe nuk ka pritur shpërblim. Jezusi është shembulli ynë për këtë. Liria është atje ku është Jezusi. Kur ne jemi shërbëtorët apo skllavërit e tij, atëhere jemi të lirë dhe nuk presim shpërblim për atë që bëjmë, përkundrazi e bëjmë nga dashuria që kemi për të. Kështu ne jemi shërbëtorë të Krishtit dhe jo më robër të kësaj bote dhe kërkesave të saj.

Jezusi dhuronte dashuri me dashje. Askush nuk e detyronte atë se kë duhet të donte e kë jo. Atë nuk e ndalte as origjina e njerëzve dhe as gabimet apo sjellja e tyre. Thjesht ai i

donte të gjithë. Ky është një tjetër aspekt i mrekullueshëm i kësaj lirie: të duash pa paragjykim. Ai arriti t'i donte të gjithë njerëzit, dhe kjo frymë u derdh edhe në zemrat tona. Le ta formojë edhe ne Shpirti i Shenjtë, që edhe ne t'i duam njerëzit, pa shikuar origjinën e tyre, gabimet e tyre madje edhe kur shoqëria thotë: „Këtë nuk duhet ta duash!“ Për këtë neve themi: „Jo! Ne jemi të lirë. Ju nuk mund të na detyroni, se kë të duam e kë jo. Ne i duam të gjithë njerëzit, siç ka vepruar vetë Jezusi.“ Kjo është një sfidë dhe me të vërtetë jo e lehtë, por me ndihmën e Jezusit dhe sa më shumë ta lemë Shpirtin e Shenjtë të veprojë brenda, aq më shumë mund të duam ne ashtu si Jezusi – pa paragjykim. „Kur unë t'ju çliroj, do të jeni me të vërtetë të lirë.“ Ne duam të jemi të lirë ashtu si Jezusi.

Nga dashuria Jezusi u bë skllav dhe u shërbeu dishepujve të tij. Ai ua lau edhe këmbët atyre. Ai arriti të bëjë atë punë që normalisht kryhej nga skllavi. Edhe nga dashuria për njerëzit u bë përsëri një me skllavin dhe mori përsipër mëkatet e tyre. Ai u dënua dhe vdiq për ne, më qëllim që ne të çliroheshim përfundimisht. Pra nga dashuria Jezusi u bë skllav, që ne të çliroheshim.

Pali shkruan, se ne jemi të thirrur për liri, por i shërbejmë njëri-tjetrit pikërisht nga dashuria (Galat 5,13). Liria e fëmijëve të Zotit nuk do të thotë: „Unë mund të bëj çfarë të dua; unë jam i pavarur, nuk kam nevojë për askënd.“ Liria e Krishtit do të thotë, të jesh pjesë e trupit të Jezusit, ku çdo gjymtyrë i shërbën njëra-tjetrës. Nga dashuria i

shërbejmë edhe ne tjetrit. Ne nuk jemi vetëm: vetëm ne dhe Perëndia, apo Perëndia dhe ne. Përkundrazi, ne jemi pjesë e trupit të Krishtit. Ne duam t'i shërbejmë njëri-tjetrit me vullnet të lirë. Asnjë nuk dëshëron ta mbajë veten për më të rëndësishëm apo më të mirë se tjetri apo të pëlqehet prej të tjerëve më shumë se tjetri. Ne nuk mendojmë kurrë se hallet tona janë më të mëdha apo më të rëndësishme se të tjerëve. Ne nuk mendojmë se idetë tona janë më të mira se të tjerëve. Le t'i shërbejmë njëri-tjetrit, le të jemi të përlurur e të ndihmojmë njëri-tjetrin, me qëllim që të çlirohemi të gjithë.

Ne dëshirojmë që të gjithë njerëzit të jenë të lirë. Ata nuk kanë pse të jenë të gjithë si ne. Ata s'kanë pse të bëhen të gjithë kanadezë. Ata mund të mbesin ata që janë. Falë Zotit nuk kanë pse të bëhen francezë për t'u çliuar. E shikoni ju nuk qeshët kur thashë kanadezë, por ... e kuptoni se çfarë dua të them. Shpeshherë ne mendojmë që njerëzit, për të qenë të lirë, të çliuar, duhet të ishin kështu siç jemi ne. Mbizotëron akoma aty-këtu pak mendimi i superioritetit: ne jemi masa, modeli. Jo, Krishti është masa matëse, ne jemi vetëm shërbëtorë. Ne duam të ndihmojmë, që të gjithë njerëzit të mund të çlirohen dhe të mund të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë. Por ne nuk presim nga ata që të bëhen kështu siç jemi ne: të kenë të njëjtin stil jetese, të kenë të njëjtat mendime apo ide, të njëjtën shije, etj. Ne i shërbejmë njëri-tjetrit, ne ndihmojmë dhe respektojmë njëri-tjetrin, edhe kur tjetri nuk është ashtu siç jemi ne. Ne jemi thirrur në lirinë e Krishtit, dhe nga dashuria i shërbejmë njëri-tjetrit.

Nëse veprojmë kështu, ne bëhemi bashkëtrashëgimtarë me Krishtin. Vetëm atëhere mund të na çlirojë me të vërtetë Krishti. Ai mund të na çlirojë prej detyrimeve të jetës njerëzore. Ne mund të marrim atë trup të ringjallurit, dhe ky nuk është asnjë subjekt i ndonjë kufizimi, qoftë kohor e as i ndonjë kufizimi tjetër tokësor. Ky trup është i lirë, ai mund të shkojë kudo që ai dëshiron. Ne do të jemi të çliuar nga çdo dobësi njerëzore, nga çdo papërsomëri. Nëse ndjekim pas Krishtin dhe nëse e pranojmë gjithnjë e më shumë këtë çlirim të tijin, atëhere ai mund të na çlirojë nga gjithçka. Atëhere mund të fitojmë atë trup të Ringjallurit dhe mund të hyjmë në mbretërinë e tij, ku nuk do të ketë as dhimbje, as vuajtje e as lot. Kjo është lumturia. Në fund të kohës Perëndia do të çlirojë nga sundimi i mëkatit të gjithë Krijimin e tij. Pali ka lënë të kuptohet tashmë se: „Në fund të kohës Perëndia do të çlirojë nga sundimi i mëkatit të gjithë Krijimin e tij, dhe do të krijojë një Krijim të ri, ku mëkati nuk do të ketë më vend.“ Ky është fundi i historisë, i gjithë historisë: çlirim, liri absolute në Perëndi dhe në Krisht.

Të dashur motra e vëllezër, le të mos harrojmë disa nga këto mendime. Jezusi na çliron. Kush beson në të, kush është i pagëzuar, do të çlirohet nga sundimi i mëkatit. Ai do të ketë mundësi të vijë tek Perëndia. Ai nuk është më i burgosur, jo më rob. Ai ka tashmë mundësinë ta kundërshtojë mëkatin: Atë se detyron askush të mëkatojë. Nëse ai vendos vetë: „Unë i them jo mëkatin; unë nuk dua të mëkatoj më,“ Jezusi do t'i dhurojë atij forcën për t'i thënë jo së keqes, të ligut. Ai nuk do të jetë më rob i saj. Ne duam të arrijmë atë liri të plotë në Jezu Krishtin dhe duam të bëhemi si ai. Ne nuk na detyron kush të jemi të bindur. Ne jemi të lirë dhe mund të ecim në rrugën e bindjes me vullnetin tonë të lirë. Kjo është rruga që të çon tek Perëndia dhe atje duam të shkojmë. Vendimin e marrim ne vetë.

Ne i shërbejmë Zotit si skllëvër të Krishtit. Ne nuk kërkojmë shpërblim, porse punojmë nga dashuria për Krishtin, sepse ai ka bërë kaq shumë për ne dhe sepse dëshëron të ndajë me ne trashëgiminë e tij. Ne i shërbejmë atij me vullnet të lirë, nga dashuria. Ne dëshërojmë të jemi në gjendje që të duam pa asnjë paragjykim, dhe sepse jemi të thirrur në lirinë, në çlirimin në Krishtin, duam të shërbejmë siç shërbente Jezusi dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin. Nuk duam të sundojmë mbi tjetrin, porse ta ndihmojmë atë dhe ta pranojmë ashtu siç është dhe duam të mbetemi besnikë deri në fund. Ne do të jemi absolutisht të çliuar për të marrë trupin e të Ringjallurit, dhe të presim Krijimin e ri, i cili do të jetë krejtësisht i lirë nga sundimi i mëkatit. Kjo është e ardhmja jonë, kjo është detyra jonë, kjo është rruga jonë.

## MENDIME KYÇE

**Jezusi erdhi për të çliuar nga sundimi i mëkatit ata, të cilët besonin tek ai. Pagëzimi me Ujë na çliron nga mëkatet e trashëguara. Shpirti i Shenjtë na hap rrugën drejt lirisë në Krishtin. Kjo liri përfshin faktin, që të duam dhe të shërbejmë sipas shembullit të vetë Krishtit.**



Fotot: privat



## Një fundjavë e bekuar për vëllezërit dhe motrat apostolikë të rinj të Shqipërisë

Vizita e Apostullit të distriktit Rainer Storck në Shqipëri, i shoqëruar nga dhjetë apostuj të zonës së tij të re të punës së bashku me bashkëshortet e tyre

Motrat dhe vëllezërit apostolikë të rinj të Shqipërisë e pritën me gëzim të madh lajmin e ardhjes së Apostulit të distriktit Rainer Storck në Shqipëri. Aido të shoqërohej në këtë udhëtim nga apostujt Franz-Wilhelm Otten, Wilhelm Hoyer, Wolfgang Schug, Gert Obdenplatz, Jens Lindemann, Clement Haeck, Jeannot Leibfried, Manuel Luiz, Pavel Gamov si dhe bashkëshortet e tyre. Vetëm apostuli nga Hollanda Kline si dhe apostuli nga Vestfalia e Rinit Verior Walter Schorr nuk mundën të merrnin pjesë në këtë udhëtim pune.

Apostuli ynë Otten e bëri atë të ditur një vit e gjysëm më parë. Viti kaloi shumë shpejt dhe përgatitjet për ardhjen e këtij grupi prej 20 vetash filluan.

Me hotelin, restorantet si dhe me kohën e lirë të grupit u mor vetë Apostuli përgjegjës për Shqipërinë, Franz-Wilhelm Otten, si dhe motra Rosmarie Lubczyk.

Vëllezërit e administratës të Shqipërisë si dhe gratë e tyre u morën me vendosjen e rregullit, riparimit si dhe pastrimit të kishës sonë në Tiranë, e cila është edhe kisha qendrore për shërbesa të tilla fetare. Kur apostuli kryesor apo ai i distriktit vijnë vetëm për një fundjavë në Shqipëri, nuk kanë mundësi të shkojnë në çdo bashkësi, kështu që mbledhen në Tiranë rreth 220 besimtarë nga 6 bashkësitë e Shqipërisë. Edhe organizimi i tyre kushton kohë e djersë. Gjetja e autobuzëve, shpërndarja e shisheve të ujit apo diçka

për mëngjes, parkimi e deri te shpërndarja e një snack-u për drekë së bashku me ujin e lëngjet që konsumohen gjatë rrugës. Ndodh shpesh që vëllezërit e administratës si dhe bashkëshortet e tyre, me gjithë përpjekjet e mëdha që bëjnë, të konfrontohen me kritika të shumta sesa me falenderime që me të vërtetë i meritojnë.

Muajt rrodhën dhe së bashku me to erdhi edhe vera e nxehtë, e cila arriti kulmin e saj në muajin kur grupi i mbartësve të bekimeve dhe grave të tyre do të vinin. E Premte, 13 Korrik. Një grup i vogël i përbërë nga Apostuli Otten dhe Gamov, i cili kish ardhur ditë më parë për të organizuar punët e mbetura për në fund, kryeplaku Andrea Rafaeli, BE Alfred Rako, Ev Fatmir Elezi si dhe motër Natasha, dolën në aeroport për t'i pritur miqtë nga Gjermania.

Megjithëse të lodhur, ata vazhduan programin e përgatitur nga shqiptarët. Në orën 18:00 prifti ynë Elton Demollari do t'i shëtiste nëpër Tiranë, duke iu shpjeguar historinë dhe vendet më të dëgjuara të kryeqytetit tonë. Shëtitja zgjati rreth dy orë.

E Shtunë, 14 Korrik. Vëllezërit e administratës së Shqipërisë kishin ardhur për të marrë pjesë së bashku me gratë e tyre në shërbesën fetare që apostuli i distriktit Storck do të mbante pikërisht për ta. Në këtë shërbesë fetare morën pjesë përveç vëll të admin aktivë edhe ata në pension. Këtë herë qenë mbledhur në sallë rreth 50 vetë. Apostuli i distriktit



Storck iu kujtoi atyre tekstin nga Bibla, të cilin Apostuli kryesor kish mbajtur për ta dy vite më parë, si dhe detyrat që ai kish lënë për ta, duke kaluar pastaj në fjalën që ai kish zgjedhur për atë shërbesë fetare. Shërbesën e pasuruan edhe predikimet e apostujve, të cilët apostuli i distriktit ftoi në altar. Vëllezërit shqiptarë dhe bashkëshortet e tyre e ndoqën me vëmendje të madhe atë shërbesë, e cila sigurisht la gjurmët e saj në punën e tyre të ardhshme.

Gjëja më e bukur që edhe organizimi i një dreke të përbashkët në oborrin e kishës. Motër Rosmarie kish organizuar një Catering me ushqime të freskëta e fruta



si dhe pije të ndryshme, disa çadra të mëdha dielli me tavolina në këmbë si dhe disa karrige e tavolina për ata më të moshuarit. Dreka kaloi në një atmosferë këndshme për të gjithë.

Mbasdite i gjithë grupi i miqve nga Gjermania bënë një eskursion për në Elbasan, ku u pritën nga një profesor i universitetit vendas, i cili u shpjegoi dhe u tregoi gjithçka rreth qytetit të vjetër Skampa si dhe kalasë së tij. Grupi mbeti i mahnitur dhe i habitur nga historia e Shqipërisë. Por vëllezërit dhe motrat tona gjermane nuk mund ta quanin të plotë vizitën e tyre në këtë qytet, nëse nuk do të ndalonin në kishën e tyre dhe njëkohësisht edhe tonën. Atje u pritën nga diakoni Alfred dhe bashkëshortja e tij Ajkuna, e cila kish përgatitur shurup trëndafili dhe bollokume.

Ja ku erdhi dhe dita e shërbesës kryesore, e Dielë 15 Korrik. Motrat e vëllezërit nga gjashtë bashkësi të ndryshme udhëtuan drejt Tiranës, për të ndjekur shërbesën fetare të Apostulit tonë të distriktit Storck. Edhe këtu ai nuk la pa përmendur që dy vjet më parë apostuli kryesor Schneider kish mbajtur shërbesën e tij me fjalën e marrë nga Mateu 7, 24.25 ku shkruhet: „Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i ve në praktikë, unë e krahasoj me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb. Ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi, por ajo nuk u shemb sepse ishte themeluar, ishte ngritur mbi shkëmb“. Shërbimi që apostuli i distriktit bëri si dhe fjala e apostujve që ai ftoi për të folur në altar entuziazmoi të gjithë motrat e vëllezërit tanë apostolikë të rinj.







Apostuli i distriktit si dhe apostujt e tjerë u ndanë ngrohtësisht nga motrat e vëllezërit tanë duke iu uruar atyre bekime të shumta si dhe mbrojtjen e engjejve në rrugë për në shtëpia.

Ditën e hënë ky grup i madh prej 20 vetash u largua ashtu thjeshtë sikurse edhe erdhi, por të bindur se vizita dhe fjala e tyre, e thënë nga altari, do të sillnin bekime për këtë vend, pasi ajo fjalë që e frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë dhe rridhte vetë Perëndia.

Edhe ne, motrat e vëllezërit shqiptarë, ju urojmë të gjithë atyre mbartësve të bekime shëndet e jetë si dhe bekimet e Perëndisë në këtë punë fisnike që ata bëjnë për të pasuruar e shpëtuar shpirtrat tanë, të motrave dhe vëllezërve që iu janë ngarkuar nën përkujdesje.

## MARIA DHE MARTA

SIPAS LUKA 10,38-42

*Jezusi dërgon dishepujt e tij për të shpallë mbretërinë e Zotit. Edhe ai vetë shkon vend më vend dhe flet rreth sundimit të Perëndisë, i cili tashmë kishte filluar. Kështu ai arriti edhe në Betanie.*

Jezusi dhe dishepujt e tij arritën në një fshat. Atje jetonte një grua, e cila quhet Marta. Ajo e pranonte Jezusin. Marta ka një motër, Maria. Ajo u ul te këmbët e Zotit dhe dëgjonte gjithçka që Jezusi u mësonte. Marta, në të kundërt përpiqet t'i shërbente Jezusit sa më shumë.



Ajo vjen tek Jezusi dhe i thotë:  
 „O Zot, a nuk të bën përshtypje,  
 që motra ime m’i le vetëm mua  
 të gjitha punët për t’i bërë?  
 Thuaji asaj që të më ndihmojë!“  
 Jezusi i përgjigjet: „Marta, Marta,  
 ti përpiqesh e shqetësohesh  
 shumë, por vetëm një gjë është  
 më e rëndësishme. Maria ka  
 zgjedhur tashmë pjesën më të  
 mirë; dhe askush nuk mund t’ja  
 marrë tani asaj atë.“






Photo: © lamppost - stock.adobe.com

## Rreth përgjithësimin të Kishës dhe të Ungjillit

Aspektet më kryesorë të besimit apostolik të ri reflektohen në tri artikujt e parë të besimit. Atje bëhet fjalë gjithashtu edhe për „Kishën si e përgjithshme“. Se çfarë do të thotë kjo, e përshkruan apostuli kryesor Jean-Luc Schneider në paragrafin që vijon.



Tri artikujt e parë të besimit apostolik të ri bazohen në besimin tonë në trininë e Perëndisë, në mishërimin e tij (bërjen njeri) në Jezu Krishtin, në Kishën e Krishtit, në shenjtërimet, në rikthimin e Krishtit dhe në jetën e përjetshme. Më poshtë dua të merrem pak me një pasazh, ndonëse të shkurtër por shumë të rëndësishëm, nga artikulli i tretë i besimit: „Ne besojmë në atë Kishë të vetme, të shenjtë, të përgjithëshme dhe apostolike.“ Kisha, për të cilën bëhet fjalë këtu, është Kisha e Krishtit, ajo shpjegohet në katekizmin tonë (KNK 2.4.3 / 6.4). Dua të theksoj këtu aspektin e mëposhtëm: Ne besojmë që Kisha është e përgjithëshme (greqisht.: katholic, katolike).

## Besimi tek përgjithësia e Kishës

Përgjithësia – pra Katoliciteti – Kisha e Krishtit përbëhet

- nga tërësia e vullnetit hyjnor për shpëtim, për çlirim. Perëndia dëshëron t’ju japë mundësi në të gjitha rrethanat, të gjithë njerëzve, në të gjitha kohërat dhe të gjithë kombeve për t’u çliruar nga mëkati dhe për të fituar bashkimin e përhershëm me të. Në kishë gjen shprehjen e tij të menjëhershme ky vullnet universal i Perëndisë për shpëtimin e shpirtave.
- nga detyra që Jezusi u dha apostujve të tij, për të shpallë Ungjillin pa asnjë kufizim – Ungjilli është i vlefshëm dhe efektiv për të gjithë njerëzit, pa përjashtim.
- nga autoriteti, që Jezusi i dha apostulatit – atje, ku apostujt janë aktivë, janë dhënë mjetet më të domosdoshme për të arritë plotësinë e shpëtimit.

Përgjithësia e Kishës mund të perceptohet vetëm me besim. Në fakt, karakteri universal i Kishës nuk perceptohet gjithnjë në formën e tij të dukshme – pra në realizimin e saj historik:

- Besimi i krishterë nuk mundi të zhvillohej kudo në të njëjtën mënyrë.
- Vërtetësia dhe aktualiteti i Ungjillit vihen në pikëpyetje.
- Domosdoshmëria e Kishës si një ndërmjetës shërues, shpëtues vihet në diskutim.
- Apostujt e tanishëm nuk njihen, nuk pranohen, nga shumica e të krishterëve.

Këto konstatime janë pothuajse njëjloj si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen. Por dyshimi dhe refuzimi që ndeshim, nuk duhet në asnjë mënyrë të dobësojnë besimin tonë në përgjithësinë e Kishës. Ne besojmë në thënien e Jezusit: Edhe „Portat e ferrit“ nuk do ta nënshtrojnë dot Kishën e Krishtit (Mateu 16,18)! Ne e dime tashmë, se

besimi ynë në përgjithësinë e Kishës është një besim i gjallë, nëse ai prodhon vepra. Këto vepra përbëhen nga shpallja universale e Ungjillit dhe nga shqetësimi, nëse Ungjilli mund të merret, të pranohet nga të gjithë

## Shpallja e Ungjillit të vlefshëm universal

Posti i apostujve ka marrë nga Jezusi detyrën për t’ua predikuar Ungjillin të gjithë krijesave (Marku 16,15). Kjo vlen për të gjithë apostulatin, pra si për apostujt e kishës së hershme, ata të kishës katolike-apostolike, ashtu edhe për ata të kishës apostolike të re.

Dëshmia jonë dhe predikimi ynë nuk bazohen vetëm tek Ungjilli dhe teoria e besimit tonë, por edhe në përjetime, në eksperiencën tonë në besim. Kur ne ushqehemi nga ky fond shpirtëror, atëhere mund të kuptojmë më mirë hallet e shqetësimit e bashkëkohësve tanë dhe ndoshta mund t’ju përgjigjemi:

- Ne mund të ngushëllojmë të varfërit dhe të pafatët me shprehjen, se Jezusi i do dhe kujdeset për ta. Ne gjithashtu mund t’i forcojmë ata duke treguar afërsinë dhe mbështetjen e të krishterëve midis njëri-tjetrit.
- Ne mund të forcojmë ata, që vuajnë dhe ata, që kanë frikë nga e ardhmja, kur i udhëzojmë për rikthimin e Jezusit dhe për jetën e përjetëshme.
- Ata që qëndrojnë në cep të shoqërisë, do të gëzohen, duke gjetur vend midis motrave e vëllezërve, midis bashkësisë.
- jeta në bashkësi u ofron besimtarëve mundësi të shumta për të kontribuar e për t’u vlerësuar, pavarësisht nga niveli i tyre i shkollimit dhe aftësisë.
- Mësimi i apostujve, pra shpallja siç duhet e Ungjillit, i mundëson besimtarët për të ndryshuar për të mirë e ndoshta madje për të arritur një stabilitet personal.

Të gjitha këto përgjigje janë të drejta dhe në përputhje me Ungjillin. Por na duhet ta pranojmë se, nuk janë njëjloj të vlefshme – ato nuk ndikojnë domosdoshmërisht në të gjithë njerëzit. Jo të gjithë janë të varfër dhe pa asnjë mjet jetese, jo të gjithë janë të sëmurë dhe kanë nevojë për ndihmë, jo të gjithë kërkojnë ngushëllim e fuqizim. Falë progresit të mjekësisë njerëzit sot nuk janë kaq nevojtarë dhe të ekspozuar kundrejt sëmundjes dhe vuajtjes. Një jetëgjatësi më e gjatë i bën njerëzit e sotëm të mendojnë për vdekjen shumë më pak sesa kanë bërë në të kaluarën. Zhvillimi i mjeteve të komunikimit dhe jeta në zonat e

populluara i lehtëson lidhjet shoqërore, saqë nuk është më e domosdoshme që t'i përkasësh një bashkësie, me qëllim që të kesh kontakte sociale. Njeriu modern nuk ka më nevojë për Perëndinë për të qenë i suksesshëm në jetën e tij ose për të gjetur ballancën e tij personale, e ndoshta as edhe për t'u bërë „ më i mirë “. Pra ai nuk ka nevojë më për ngushëllime të shumta, të cilat i përkasin normalisht predikimit dhe kujdesit shpirtëror!

Rezultati: Dëshmia jonë nuk ka më atë forcë, atë influencë ndaj partnerit me të cilin flasim. Sidomos ndaj më të rinjve, të cilët nuk janë në nevojë ekzistenciale, ne shpesh nuk gjejmë më jehonë. Atëhere neve na këshillohet që të përqendrohemi tek thënia universale e Ungjillit, e cila vlen për të gjithë njerëzit: Universaliteti i Ungjillit bazohet mbi atë çka Jezu Krishti na meson rreth Perëndisë, rreth nesh, rreth lidhjes sonë me Perëndinë dhe me tjetrin, të afërmin dhe rreth atij çlirim, të cilin Perëndia e përgatit për ne:

- Jezusi na zbulon neve përsosmërinë e Perëndisë – ne nuk njohim gjë më të mirë, përveç atij (Psalmi 16,2; Mateu 5,48).
- Jezusi na mëson, se Perëndia është vetë dashuria. Ai don pa kushte. Ai kërkon prej nesh që ta reflektojmë dashurinë e tij me vullnet të lirë – pa qenë të detyruar.
- Ungjilli na e zbulon Perëndinë si një Trini: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë tri persona të ndryshëm të lidhur përsosmërisht në një. Vetëm bashkimi me këtë Perëndi u mundëson njerëzve të kapërcejnë, të mposhtin dallimet, ndryshimet, me qëllim që të arrijnë një unitet ndërmjet tyre
- Nëpërmjet vdekjes dhe ringjalljes së tij, Jezu Krishti ka hapur hyrjen drejt mbretërisë së Perëndisë. Për të qenë krejtësisht të lirë nga e keqja, nga i ligu në ardhjen e Jezusit, ne duhet të ndjekim fjalët dhe veprat e tij dhe ai duhet të jetë shembulli ynë.
- Perëndia dëshëron të na dhurojë ne paqen e plotë, duke na lënë të bëhemi ata, për të cilët ai na ka krijuar – njerëz sipas shëmbëlltyrës së tij, të cilët do të jetojnë të bashkuar përjetësisht me të.

Ky lajm, ky mesazh është me të vërtetë universal. Ky duhet të jetë bërthama e predikimit të apostujve dhe e çdo predikimi tjetër!

## Shpallja universale e Ungjillit

Lajmi i gëzuar u duhet shpallur të gjithë njerëzve.

Ndonjëhere neve kemi preferuar të varfrit dhe të pafavorizuarit, pasi kemi menduar se situata në të cilën ata

ndodhen i bën ata më të hapur ndaj Ungjillit. Kjo strategji nuk ka qenë gjithnjë e dobishme, pasi doli, pasi u vu re, se atyre njerëzve u mungonin rrënjët e besimit. Ka ndodhur njëkohësisht që ne të kemi hezituar për të rënë në kontakt me grupe të caktuara njerëzish, vetëm sepse kemi menduar, që kushtet nuk ishin të favorshme për ne. Këtu mendoj ata njerëz, të cilët jetojnë në varfëri ekstreme ose që u duhet të jetojnë nën dhunë, dhe këtu është krejtësisht e kundërta, ata që janë të arsimuar apo të pasur. Jam i bindur, se ne duhet gjithnjë e më shumë t'i drejtohem jo të krishterëve. Le të tregojmë kurajën e të krishterëve të parë dhe të mos njohim kufi në shpalljen e Ungjillit. Të mos hezitojmë për të qenë novatorë!

Që të shpallësh lajmin e gëzuar të Ungjillit në mënyrë sa më bindëse, nuk duhet as „ të djallosim“ jetën këtu në tokë, dhe as të nxijmë të ardhmen. Një mendim i tillë do ta bënte një pjesë të konsiderueshme të popullsisë të paarritshme për të vërtetën e Ungjillit. Ndjekja pas Krishtit nuk bie në kundërshtim me bërjen e një jete të këndshme, të rehatshme këtu në tokë, përkundrazi: ajo mund të kontribuojë për këtë!

Shpallja universale e Ungjillit përjashton çdo pretendim për uniformitet! Jeta e re në Krisht mund të zhvillohet nën një sërë kushtesh ekonomike, mendore dhe kulturore! Për të ndjekur mësimet e apostujve, brezi i ri nuk ka nevojë të ketë të njëjtat preferenca me paraardhësit e tyre! Le të drejtohem prej shembullit të apostul Palit: „Për Judët jam bërë si judë, me qëllim që t'i fitoj ata. Për ata, të cilët ndjekin ligjet, jam vënë edhe unë nën këto ligje – pavarësisht se vetë nuk qëndrojnë nën këto ligje –, me qëllim që të fitoj edhe ata, të cilët qëndrojnë nën këto ligje. Për ata, të cilët nuk jetojnë nën ligje, jam bërë edhe unë si ata – megjithëse nuk jetoj kurrë pa ligjet e Perëndisë, përkundrazi jetoj sipas ligjit të Krishtit –, me qëllim që të fitoj edhe ata, të cilët jetojnë pa ligje. Për të dobtit jam bërë edhe unë i dobët, me qëllim që t'i fitoj edhe ata. Unë jam bërë gjithshka për të gjithë, me qëllim që në çdo mënyrë të shpëtoj disa. Porse gjithshka e kam bërë për hir të Ungjillit, për të pasë pjesë në të“ (1. Korint 9,20–23). Në këtë mënyrë, apostuli eci, ndoqi gjurmët e dërguesit të tij: Për të na sjellë këtë lajm të gëzuar, „e zbrazi veten e tij [Biri i Perëndisë], duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit“ (Filip 2,7).

Kisha katolike është konfrontuar me këtë problematikë shumë më përpara se ne, për këtë arsye ajo ka zhvilluar idenë e “inkulturimit”. Sipas Yves Congar (1904-1995), një teolog katolik, inkulturacioni bazohet në: „për të futur, për të mbjellë dhe zhvilluar farën e besimit në një kulturë

dhe për ta rritur atë sipas mjeteve dhe natyrës së asaj kulture“ (marrë jo fjalë për fjalë nga fjalori: Dictionnaire critique de Théologie, JeanYves Lacoste, Éditions PUF). Ne do të bënim mirë, që të udhëhiqemi nga kjo ide, kur u dëshmojmë njerëzve të kulturave jo-perëndimore rreth Ungjillit ose kur duam t'ua transmetojmë besimin tonë brezave të ardhshëm.

## Kisha, një dëshmitar universal

Nuk është përgjegjësia jonë vetëm të shpallim Ungjillin tërësisht dhe tek të gjithë, ne duhet të sigurohemi gjithashtu, që dëshmia jonë të merret e të pranohet nga të gjithë. Edhe një herë është po Jezu Krishti ai, të cilin duhet ta marrim si shembull. „Unë linda dhe erdha në këtë botë, me qëllim që të dëshmoj të vërtetën“ (Gjoni 18,37).

Ne mund të jemi dëshmitarë universalë të Ungjillit vetëm, nëse jemi të besueshëm, domethënë, kur jemi të denjë për mesazhin që shpallim. Sipas shembullit të Jezusit ne duhet

- të jemi të sigurt – besimi ynë na jep siguri të patundur në atë që shpresojmë (Hebr 11,1), dhe ky besim duhet të jetë i dukshëm në mjedisin tonë.
- të jemi të vendosur për të kapërcyer të keqen – dëshmia e një të krishteri të vetkënaqur nuk është e besueshme.
- të jemi të përlulur – Jezusi bëri pikërisht atë, që Ati i tij kërkonte prej tij. Ne jemi në shërbim të Jezusit. Le të jemi të kënaqur duke bërë atë, që ai pret prej nesh. Nuk duhet që mëkatarët të gjykojnë mëkatarët e tjerë (Gjoni 8,7). Përkundrazi, Jezusi nuk na lejon të gjykojmë tjetrin (Mateu 7,1).
- të mos jemi të lidhur, të varur – sa më pak të jemi të lidhur me gjërat materiale dhe me nderimin personal, aq më të lehtë do ta kemi të falim të tjerët, ata që na dëmtojnë.
- të jemi të mbushur me dashurinë ndaj Perëndisë dhe ndaj tjetrit. Ngaqë e duam Jezusin, jemi të gatshëm të vuajmë me të dhe për të. Le ta duam tjetrin me të vërtetë dhe me vepra (1. Gjoni 3,18).

Duke e përmbledhur kërkoj nga ne: Le të qëndrojmë të lidhur fort në besimin ndaj Kishës së Krishtit dhe në

qëllimin e saj gjithpërfshirës! Ajo është thirrur, ka për detyrë t'u shpallë të gjithëve Ungjillin universal. Detyra jonë është,

- të shpallim mesazhin universal të shpëtimit dhe të mos kapemi fort pas aspekteve dytësore.
- të ndjekim impulset e Shpirtit të Shenjtë, me qëllim që të shpallim mesazhin e gëzuar pa asnjë kufizim.
- drejtohem sipas shembullit të Krishtit, për të qenë dëshmitarë të vërtetë.



Photo: © Patrick Daxenbichler - stock.adobe.com

### Masthead

Autori: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrih/Zvicër  
Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany  
Editori: Peter Johanning



# Programi

- 06.01.2019 Bern (Zvicër)
- 12.01.2019 Huambo (Angola)
- 13.01.2019 Benguela (Angola)
- 20.01.2019 Mainz (Gjermani)
- 27.01.2019 Cape Coast (Gana)
- 03.02.2019 Berlin (Gjermani)
- 10.02.2019 Charlotte (USA)
- 03.03.2019 Bujumbura (Burundi)
- 10.03.2019 Rosenheim (Gjermani)
- 15.03.2019 Colonia (Uruguay)
- 17.03.2019 Colonia (Uruguay)
- 24.03.2019 Dessau (Gjermani)
- 31.03.2019 Kampala (Uganda)

New Apostolic Church  
International

